



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1017/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Pelikan SHPK NUIS J61825529G me seli ne Durres Shqiperi rr. Egnatia Kulla Fly kati 13 te cilin e përfaqëson A.M avokate, ndaj debitorit Shehu OilL SHPK me NUI 810172651 me slei ne Rahovec, rr Xhelal Hajda p.n. me pronar I.Sh te cilën e përfaqëson F.H avokat, bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.1506/22 të datës 01.06.2023, me datën 24.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Pelikan SHPK NUIS J61825529G me seli ne Durres Shqiperi rr. Egnatia Kulla Fly kati 13 te cilin e përfaqëson A.M avokate, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.1506/22 të datës 01.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor Pnr.587/21 të datës 11.10.2021, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat, si dhe te paguaj shpenzimet e procedurës ne lartësi prej 104€.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anulohet, dhe te kthej çështjen ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në baze të faturave të listuar në aktvendimin e ankimuar dhe propozimin për Urdhër përmbarrimor. Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor Pnr.587/21 të datës 11.10.2021, i ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 8700€, si dhe shpenzimet procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim debitori me pretendimin që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në baze të faturave të listuara në aktvendimin e ankimuar dhe propozimin për Urdhër përmbarrimor. Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor Pnr.587/21 të datës 11.10.2021, i ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 8700€, me kamat ligjore nga dita e lejimit të përmbarrimit e deri të pagesa definitive si dhe shpenzimet procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim debitori me pretendimin që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi nuk janë pranuar nga debitori, të njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti në emër dhe mbiemër dhe si të tilla nuk përbejnë bazë për përmbarrim, ndërsa kreditori nuk ka mundur të argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë me të cilin se faturat i janë dorëzuar debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Në këtë rast e rëndësishme

është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Andaj, faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, te njëjta nuk janë të vullosura e as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokumente të besueshme, ndërsa vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1017/23, me datë 24.10.2023

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi